



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE  
KËSHILLI DREJTUES**

**VENDIM**

**Nr. 32, datë 28.10.2025**

**PËR  
MIRATIMIN E “PASQYRAVE FINANCIARE TË  
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE  
PËR TREMUJORIN E TRETË TË MBYLLUR MË 30 SHTATOR 2025”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52 pika 1, shkronja “l” dhe nenit 62, pika 1 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja “c”, të nenit 9, pika 3 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 6/1, shkronja “e” të Rregullores nr. 20, datë 25.09.2017 “Për nënshkrimet e autorizuara në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të nenit 18, pika 2 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, si dhe me propozim të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e “Pasqyrave financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për tremujorin e tretë të mbyllur më 30 shtator 2025”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sektori i Financës dhe Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

